Za prekršaj iz stava 1. ovog člana, kazniće se odgovorno lice u pravnom licu novčanom kaznom od 5.000 do 75.000 dinara.

Za prekršaj iz stava 1. ovog člana, kazniće se preduzetnik novčanom kaznom u iznosu od 10.000 do 250.000 dinara.

Član 37.

Novčanom kaznom u fiksnom iznosu od 5.000 dinara kazniće se fizičko lice ako:

1. drži pse i mačke u većem broju od broja pasa i mačaka propisanog članom 20. ove odluke,
2. izvodi psa bez povocu i bez zaštitne korpe na njušci i ako nema kod sebe potvrdu o izvršenom obeležavanju psa i vakcinaciji
3. pušta psa da se slobodno kreće suprotno odredbi člana 27. stav 1. ove odluke,
4. zlostavlja, muči i napušta domaće životinje i kućne ljubimce
5. uvodi domaće životinje i kućne ljubimce u službene prostorije, dečija igrališta, pijace ili na druga javna mesta
6. izvodi i šeta pse na sportskim, rekreativnim i drugim mestima masovnog okupljanja građana, izuzev javnih zelenih površina koje odredi nadležno javno preduzeće

VI. PRELAZNE I ZAVRŠNE ODREDBE

Član 38.

Vlasnici, odnosno držaoci domaćih životinja i pravna ili fizička lica kojima je predmet poslovanja čuvanje ili uzgoj životinja dužni su da uslove i način držanja i zaštite domaćih životinja usklade sa odredbama ove odluke u roku od 12 meseci od dana stupanja na snagu ove odluke.

Vlasnici, odnosno držaoci kućnih ljubimaca u smislu odredaba ove odluke dužni su da uslove I način držanja i zaštite istih usklade sa odredbama ove odluke u roku od tri meseca od dana stupanja na snagu ove odluke.

Član 39.

Posebnim aktom Skupštine grada reguliše se postupak i način rešavanja zahteva građana za naknadu štete nastale usled ujeta pasa lualica.

Član 40.

Postupci koji nisu okončani do dana stupanja na snagu ove odluke, okončaće se po odredbama odluke koja je važila u momentu pokretanja postupka, ukoliko nisu u suprotnosti sa zakonom i odredbama ove odluke.

Član 41.

Ova odluka stupa na snagu osmog dana od dana objavljivanja u "Službenom glasniku opštine Preševo".

OPŠTINSKO VEĆE OPŠTINE PREŠEVO

III:br.32-1

U Preševu dana 30.05.2025. god.

P r e d s e d n i c a
Ardita Sinani s.r

44.

Në mbështetje të nenit 70 Statutit të komunës Preshevë („Gaz.zyrtare e komunës së Bujanocit“, 12/21) dhe neni 5 Vendimit mbi Këshillin komunal të komunës Preshevë („Gaz.zyrtare e komunës Preshevë“ nr.5/2024), Këshilli komunal I komunës Preshevë, në mbledhjen e mbajtur më 30.05.2025 nxjerr:

Vendimin komunal mbi mënyrën e ruajtjes së kafshëve shtëpiake në teritorin e komunës Preshevë

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1.

Me këtë Vendim parashihen kushtet më të përafërta dhe mënyra, vendi dhe hapsira ku mund të mbahen kafshët shtëpiake dhe kafshët e përkëdhelura mund të mbahen për qëllime jokomerciale në teritorin e komunës Preshevë (në tekstin vijues: Komuna), vendi dhe mënyra e nxjerrjes së kafshëve të përkëdhelura e veçmas qenve dhe macave në sipërfaqe publike, organizimi I shërbimi zoohigjienik dhe sigurimi I strehimoreve për kafshët e braktisura si dhe mbrojtja e kafshëve shtëpiake.

Neni 2.

Kafshët shtëpiake në bazë të dispozitave të këtij Vendimi janë: kafshët thundrake, ungunat, shpezët dhe pëllumbat.

Neni 3.

Kafshët shtëpiake në bazë të dispozitave të këtij Vendimi janë kafshët që mbahen për shoqëri dhe ato janë: qent, macat dhe zogjë.

Neni 4.

Pronari gjegjësisht mbajtësi I kafshëve shtëpiake dhe përkëdhelësve shtëpiake në bazë të dispozitave të këtij Vendimi është çdo person juridik ose fizik, gjegjësisht ndërmarrës I cili si pronar është përgjegjës për jetën, mbrojtjen e shëndetit dhe mirëqenjen e kafshëve.

Neni 5.

Pronari, gjegjësisht mbajtësi I kafshëve është I obliguar që :

1) ndaj kafshëve të vepron me kujdes si strehues I mirë dhe të siguron kushte për mbajtjen dhe kujdesin e kafshëve që I takojnë llojit, rasës,gjinisë, moshës si dhe specifikave dhe karakteristikave fizike, biologjike dhe prodhuese në sjelljen dhe gjendjen shëndetsore të kafshës,

2) me kohë të siguron ndihmën e veterinerit nëse kafsha është sëmurë, gjatë lindjes së kafshës si dhe kujdesin për një kafshë të sëmurë, të lënduar dhe të dobësuar.

Pronari gjegjësisht mbajtësi I kafshës është përgjegjës për jetën, shëndetin dhe mirëqenjen e kafshës dhe duhet të ndërmerr të gjitha masat e domosdoshme si ti siguron kafshës që të mos I shkaktohen dhimbje të panevojshme, vuajtje, frigë dhe stress, gjegjësisht lëndime.

II MBAJTJA E KAFSHËVE SHTËPIAKE DHE PËRKËDHELËSVE SHTËPIAK

Neni 6.

Mënyra dhe kushtet e mbajtjes së kafshëve shtëpiake dhe përkëdhelësve shtëpiak m’varet nga lloji I objektit banesor dhe pjesa e teritorit të komunës Preshevë në të cilën gjindet objekti banesor.

Objektet banesore sipas dispozitave të këtij Vendimi janë: ndërtesat e banimit, shtëpitë familjare me më së shumti katër apartamente (në tekstin vijues: shtëpi familjare).

Neni 7.

Oborri sipas dispozitave të këtij vendimi është pjesë e mbetur e parcelës ndërtimore që I takon ndërtesës banesore gjegjësisht shtëpisë familjare.

Oborri nga paragr.1 këtij neni duhet të jetë I rrethuar nëse në te mbahen kafshët shtëpiake ose përkëdhelësit e shtëpisë.

Në përjashtim nga paragr.2 këtij neni nuk ka nevojë oborri të rrethohet nëse kafshët shtëpiake mbahen në hapsirën e rrethuar.

Neni 8.

Kafshët shtëpiake nga neni 2 këtij vendimi mund të mbahen në pajtim me dispozitat e këtij Vendimi në hapsirat si vijon:

- njëthundrakët dhe shpezët – në oborrin e shtëpisë familjare,
- shpezët- në oborrin e shtëpisë familjare, oborrin e përbashkët të shtëpisë familjare,
- pëllumba- në ndërtesën banesore, oborrin e ndërtesës banesore, shtëpinë familjare oborrin e shtëpisë familjare, oborrin e përbashkët të shtëpisë familjare.

Neni 9.

Përkëdhelësit shtëpiak në pajtim me dispozitat e këtij Vendimi, mund të mbahen në hapsirat si vijon: banesë në ndërtesën banesore, oborrin e ndërtesës banesore, shtëpinë familjare, oborrin e shtëpisë familjare, oborrin e përbashkët të shtëpisë familjare.

Përkëdhelësit shtëpiak mund të mbahen me kusht që mos të shqetësojnë palët e treat dhe të mos ndotin mjedisin.

Neni 10.

Kafshët njëthundrak dhe thundrak, shpendët me pendë mund të mbahen jashtë zonës së përmendur në nenin 10, paragr.3 dhe 4 të këtij Vendimi në teritorin e komunës Preshevë, sipas kushteve të veçanta të parapara me këtë Vendim.

Dispozitat e këtij Vendimi që parashohin mbajtjen e përkëdhelësve shtëpiak zbatohen në tërë teritorin e komunës Preshevë.

1. Njëthundrakët dhe thundrakët

Neni 11.

Njëthundrakët sipas këtij Vendimi janë: kuajt, gomarët dhe mushkat, kafshët thundrake janë: gjedhet, delet dhe dhitë mund të mbahen në objektet e veçanta në kopshtet e shtëpive familjare dhe në kopshtet e përbashkëta të shtëpive familjare por ose me pëlqimin paraprak të të gjithë bashkëpronarëve.

Objektet nga paragr.2 këtij neni duhet të jenë të siguruara dhe të mbrojtura për kafshët, nga materiali I fortë dhe nëse ato lirohen për kullosje të lirë, kullotat duhet të jenë të rrethuara nga një gardh I fortë mjaftueshëm I lartë sa qent endacak të mos mund të kërcejnë mbi të dhe duhet të monitorohen vazhdimisht. Objekti nga paragr.1 këtij neni më së paku 10m larg ndërtesës më të afërt banesore ose objektit afarist në parcelën fqinjë.

2. Shpezët me penda

Neni 12.

Jashta teritorit të paraparë me nenin 10 paragr.3 dhe 4 të Vendimit, shpezët me penda mund të mbahen në object të posaçëm, që duhet të jetë I sigurt dhe I mbrojtur për shpezët, nëse lirohen në kullotje të lirë, kullosa duhet të jetë e rrethuar nga rrethoja e fortë dhe lartësi të mjaftueshme të cilën nuk munden qent endacak ta kërcejn.

Objekti nga paragr.1 këtij neni për mbajtjen e shpezëve me qëllime jokomerciale duhet të jetë I larguar më së paku 10m nga objekti më I afërt banesor ose objekti afarist në parcelën fqinjë.

3. Pëllumbat

Neni 13.

Me pëllumba sipas këtij Vendimi nënkuptohen pëllumbat e të gjitha llojeve.

Neni 14.

Pëllumbat mund të:

- mbahen në çati ose papafingo në një ndërtesë banesore në një hapsirë të rrethuar posaqërisht, me pëlqimin e marrur më parë të të gjithë pronarëve të banesës dhe pjesëve të veçanta të ndërtesës banesore,
- mbajtja në papafingo ose tarasë në shtëpi familjare, në hapsirën e veçantë të rrethuar,
- të mbahen edhe në oborrin e shtëpisë familjare në hapsirën e ndërtuar veçmas, me kusht që të jetë largë

më së paku 10m nga objekti banesor më I afërt ose objekti afarist në parcelën fqinjë.

Në oborrin e ndërtesës banesore, oborrin e përbashkët të shtëpisë familjare pëllumbat mund të mbahen në hapsirën e rrethuar posaqërisht, me kusht që të jetë më së paku 10m larg nga objekti më I afërt banesor ose objekti afarist në parcelën fqinjë dhe me pëlqimin e marrë më parë të të gjithë pronarëve të banesës dhe pjesëve të veçanta të ndërtesës banesore, bashkëpronarëve të shtëpive familjare gjegjësisht pëlqimin e të gjithë pronarëve të shtëpive familjare që gjinden në oborrin e përbashkët.

4. Qent dhe macat

Neni 15.

Qent dhe macat mund të mbahen në banesë dhe në shtëpinë familjare.

Në ndërtesën banesore ose shtëpinë familjare nuk është lejuar mbajtja e qenit dhe macës në ballkon, taras, lozhë, papafingo, bodrum, garazhë, hambarë ose në hapsirë tjetër të përbashkët.

Është e lejuar futja e qenit dhe macës në ashensor të një ndërtese banesore nëse nuk e shfrytëzojnë në të njëjtën kohë banorët ose qytetarët.

Personat me invaliditet mund të fusin qent udhërrëfyes në ashensor të ndërtesës banesore dhe të njëjtën ta shfrytëzojnë në të njëjtën kohë me banorët dhe qytetarët.

Neni 16.

Qent mund të mbahen në oborrin e ndërtesës banesore, në oborrin e shtëpisë familjare dhe oborrin e përbashkët të shtëpisë familjare në objektin e veçantë me pëlqimin e marrur më parë të të gjithë pronarëve të banesës dhe pjesëve të veçanta të ndërtesës banesore, bashkëpronarëve të shtëpive familjare gjegjësisht pëlqimin e të gjithë pronarëve të shtëpive familjare që gjinden në oborrin e përbashkët.

Objekti nga paragr.1 këtij neni për mbajtjen e qenve duhet të jetë larg më së paku 10m nga ndërtesa më e afërt banesore ose objekti afarist në parcelën fqinjë, gjegjësisht shtëpive tjera në oborr me numrin më të madh të shtëpive familjare.

Neni 17.

Pronari, gjegjësisht mbajtësi I qenve është I obliguar që në portën hyrëse në oborr të ndërtesës banesore dhe shtëpive familjare dhe në derën hyrëse të banesës në

vendin e dukshëm të vendos tabelën me vizatimin e një qeni dhe mbishkrimin “KUJDES NGA QENI”.

Neni 18.

Në një banesë mund të mbahen një qen ose një macë.

Pronari gjegjësisht mbajtësi I qenit ose macës mund të njejtit ti mbajë në banesë me kusht ti siguroj kushte në pajtim me dispozitat e nenit 5 të këtij Vendimi.

Në oborrin e shtëpisë familjare mund të mbahen më shumë se dy qenë.

Neni 19.

Qeni I cili mbahet në oborrin e rrethuar individual nuk duhet të jetë I lidhur, me kusht që lartësia e rrethojës dhe fortësin të pamundëson qenin të dalë nga oborri dhe ti siguron mbrojtje kalimtarëve.

Në oborrin e ndërtesës banesore dhe oborrin e përbashkët të shtëpisë familjare qeni duhet të mbahet në hapsirën e rrethuar ashtu që të mos ekzistojë mundësia ta lëshon hapsirën ose në një mënyrë tjetër rrezikon ose shqetëson fqinjët dhe kalimtarët.

Në oborrin e ndërtesës banesore dhe oborrin e përbashkët të shtëpisë familjare qeni mund të mbahet vetëm nëse ekziston pëlqimi I të gjithë pronarëve të banesave dhe shtëpive familjare.

Pronari, gjegjësisht mbajtësi I qenit nuk guxon të mbajë qenin përher të lidhur në zinxhirë ose në mënyrë tjetër të ngajshme të lidhur, përveç se nëse është I lidhur në zinxhirin e zgjatur ose është I vendosur në shtëpizën e vetë.

Neni 20.

Qenët që mbahen si përkëdhelës shtëpiak, e që mund të paraqesin rrezik për rrethin (në tekstin vijues: qent e rrezikshëm) mbahen në pajtim me dispozitat e posaçme me të cilat rregullohet mënyra e mbajtjes së qenve që mund të paraqesin rrezik për rrethin:

Qeni I rrezikshëm nga paragr.1 këtij neni, I cili mund të paraqet rrezik për rrethin, që është cili do lloj e njerës, përveç qenit zyrtar, që është:

1. pa asnjë arsye të dukshme sulmon një person dhe I shkakton lëndime trupore ose vdekje,
2. pa asnjë arsye të dukshme sulmon nje qen tjetër dhe I shkakton lëndime të rënda trupore ose vdekje,
3. I rritur, gjegjësisht I stërvitur për luftime qenësh ose I gjetur në një përlëshje të organizuar me një qen tjetër,
4. I dedikuar për ruajtjen e pronës ose si truproje,

5. një rasë pitbull terrier ose një përzierje e asaj race, e cila nuk vjen nga mbarështimi I kontrolluar.

Neni 21.

Qent e rrezikshëm mund ti nxjerrin në shëtitje vetëm personat e rritur, me një shportë mbrojtëse dhe me zinxhirë, në pajtim me dispozitat e veçanta.

Pronari, gjegjësisht kujdestari I një qeni të rrezikshëm nuk guxon t’ia jep qenin një personi tjetër për ruajtje dhe strehim të përkohshëm, përveç se për qëllimin e sigurimit të trajtimit të qenit nga një veteriner.

Pronari, gjegjësisht kujdestari I një qeni të rrezikshëm duhet të siguroj që ai qen, pa’mvarsisht nga mosha e tij të shënohet me një mikroçip, në pajtim me dispozitat e veçanta.

Pronari, gjegjësisht kujdestari I një qeni të rrezikshëm të njejtin duhet ta mbajë në hapsirë, gjegjësisht në object që I përgjigjet madhësisë dhe nga e cila qeni nuk mund të ikë.

Në hyrje të hapsirës, gjegjësisht objektit ku vendoset qeni I rrezikshëm duhet të jetë e shënuar dukshëm paralajmërimi: “QENI I RREZIKSHËM”.

Hyrja në local ose object ku mbahet qeni I rrezikshëm duhet mbyllur me çels.

Me rastin e nxjerrjes së qenit të rrezikshëm në sipërfaqe publike, pronari, gjegjësisht kujdestari, si dhe personi I cili e nxjerr është I obligueshëm që me vete të ketë vërtetimin për qenë të lëshuar në pajtim me dispozitën e veçantë.

Neni 22.

Pronari gjegjësisht kujdestari I qenit është I obliguar të bënë regjistrimin dhe shënimin e qenit në mënyrë të paraparë me ligj dhe me akte nënligjore.

Pronari gjegjësisht kujdestari I qenit ose macës është I obliguar që rregullisht të bëjë vaksinimin e qenit ose macës kundër tërbimit në pajtim me ligjin.

Pronari gjegjësisht kujdestari I qenit është I obliguar që qenin deri në tre muaj ta paraqet në shërbimin kompetent të veterinarisë për arsye të regjistrimit.

Neni 23.

Pronari, gjegjësisht kujdestari I qenit është I obliguar që qenin ta nxjerr jashtë në zinxhirë dhe me shportë mbrojtëse në gojë.

Pronari gjegjësisht kujdestari I qenit, si dhe personi I cili e nxjerr qenin jashtë bartë përgjegjësin e plotë për sjelljen e tij në sipërfaqe publike.

Pa shportën mbrojtëse në gojë, e në zinxhirë përkatës mund të nxirren jashtë qent e vegjël dhe të mesëm si dhe këlyshët deri në katër muajsh.

Gjatë nxjerrjes së qenit jashtë pronari, gjegjësisht kujdestari është I obliguar që me vete të ketë vërtetimin për shënimin e kryer të qenit dhe vaksinimit.

Neni 24.

Qeni mund të lirohet pa zinxhirë për të lëvizuar lirisht vetëm në park dhe në vende tjera publike si zona e gjelbërt dhe ate:

- u në kohën prej orës 22.00 deri në orën 09.00 të ditës së nesërme, në periudhën e llogaritjes së kohës verore, gjegjësisht në kohën prej orës 20.00 deri në orën 10.00 të ditës së nesërme, në periudhën e llogaritjes së kohës dimërore;

- në afërsi të drejt për drejt të shkollës periudha kohore nga al.1 paragr.1 këtij neni kufizohen deri në ora 7.30 të ditës së nesërme, pa marrë parasysh në periudhën e llogaritjes kohore, përveç në kohë të pushimeve të shkollës dhe ditëve jo pune; Dispozita e paragr.1 të këtij neni nuk vlen për qent e rrezikshëm.

Është e ndaluar të lirohet qeni me zinxhirë që lirshëm të lëvizë në pjesën e parkut dhe në sipërfaqe tjera të gjelbruara publike, ku gjindet parku I rregulluar I fëmijëve si dhe në pjesën e mbjellur me lule.

Neni 25.

Qent munden të lëvizin lirshëm nën kontrollin e pronarit, gjegjësisht kujdestarit në sipërfaqet që janë të caktuara për nxjerrjen e qenve.

Veçmas qent e gjyetisë për kohë të gjyetisë, qent zyrtar gjatë aksionit policor, kërkimit për personat e humbur dhe të ngajshme dhe qenët e bagëtisë për kohë të ruajtjes së bagëtisë munden lirshëm të lëvizin pa kontrollim dhe përgjegjësin e pronarit gjegjësisht kujdestarit, pa shportën mbrojtëse në gojë.

Neni 26.

Nëse qeni gjatë nxjerrjes jashtë dhe lëvizjes ndotë sipërfaqet, pronari gjegjësisht kujdestari I të njejtit është I obliguar ti pastroj ato pa vonesë.

Pronari, gjegjësisht mbajtësi I përkëdhelësve shtëpiak është I obliguar që gjatë çdo daljeje në sipërfaqe publike bartë me vete paisjen për pastrimin e jashtëqitjeve sa herë që del në sipërfaqe publike të cilën përkëdhelësi I tij shtëpiak e ka ndotur.

Përmbajtja e mledhur, pronari, gjegjësisht kujdestari është I obliguar ti hedh në kontenjer të posaçëm që janë të vendosura në sipërfaqet publike për këtë dedikim dhe të cilat janë të vendosura në vende të dukshme ose në rast se qeni, maca ndotin shkallët e përbashkëta ose pjesët tjera të përbashkëta të sipërfaqeve, pronari gjegjësisht kujdestari I të njejtës është I obliguar që sipërfaqen e ndotur ta pastroj dhe lajë e sipas nevojës edhe ta dezinfektoj.

Neni 27.

Është e ndaluar futja e qenve dhe macave në objekte publike, përveç në objekte tjera ku dukshëm është shënuar se futja e përkëdhelësve shtëpiak është e lejuar.

Qent mund të futen në objekte publike nga paragr.1 këtij neni, vetëm me zinxhirë të shkurtër me pronarin ose kujdestarin dhe çdo pronar ose kujdestar është I obliguar që qenin ta mbajë nën kontrollë dhe është përgjegjës për çdo dëm eventual ose incident që e shkakton qeni I këtij.

Është e ndaluar futja e qenve të rrezikshëm në objekte publike.

Futja e qenve dhe macave në mjetet e transportit public është e lejuar me kusht që të vendosen në kafaz ose kuti transporti nga e cila nuk mund të lirohen.

Si përjashtim nga dispozita e paragr.1,2 dhe 4 të këtij neni në objekte publike dhe në mjete të transportit public është e lejuar futja e qenve përcjellës në pajtim me dispozitat e ligjit me të cilën rregullohet lëvizja me ndihmën e qenve përcjellës.

Pronari, gjegjësisht kujdestari I një qeni ose maceje është I obliguar të ndërmerë masa të domosdoshme që kjo kafshë të mos kafshojë ose në mënyrë tjetër lëndojë personin e tretë.

Neni 28.

Personi I cili në kohë të gjatë, fizikisht ose duke I ushqyer mbanë qenë dhe maca të braktisura ka të njejtat obligime lidhur me kujdesin dhe mbajtjen e tyre si pronar, gjegjësisht kujdestar I kafshëve dhe është I obliguar që ti përmbahet rregullave të mbajtjes së kafshëve të parapara me këtë Vendim.

Neni 29.

Nëse pronari, gjegjësisht kujdestari I qenit ose macës, me mos sigurimin e kushteve për mbajtjen në pajtim me ligjin dhe me këtë vendim abuzon kafshën ose vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij vendimi, ose përshkak të kushteve joadekuate kafsha rrezikon sigurinë e qytetarëve ose shqetëson

përgjithmonë mjedisin, ajo mund ti konfiskohet përkohësisht ose përgjithmonë në pajtim me Ligjin.

Pronari, gjegjësisht kujdestari I qenit është I obliguar të paguajë shpenzimet e vendosjes së qenit në strehimore, nëse qeni është konfriskuar përkohësisht.

Neni 30.

Qeni I cili pa arsye të dukshme ka sulmuar një person dhe I ka shkaktuar lëndime trupore duhet të ndëshkohet nën mbikqyrjen dhe vëzhgim në përputhje me Ligjin.

Të dhënat mbi qenin nga paragr.1 këtij neni dhe rrethanat në të cilat ka ndodhur sulmi, qytetari I cili është sulmuar nga ana e qenit, qytetari tjetër, organi shtetëror ose institucioni shëndetsor ia dërgojnë inspekcioni komunal .

Shërbimi zoohigjienik kap qent nga paragr.1 këtij neni ndërsa vështimin e të njejtës e bënë stacioni I autorizuar I veterinarisë, gjegjësisht ambulance veterinare.

Shpenzimet e kapjes dhe vëzhgimit të qenve i mbulon pronari gjegjësisht kujdestari I qenit, nëse pronari, mbajtësi nuk dihet, bie në barrë të komunës së Preshevës.

III. MASAT E NDALIMIT

Neni 31.

Është e ndaluar në pajtim me dispozitat e këtij Vendimi:

1. abuzimi, tortura dhe braktisja e kafshëve shtëpiake dhe kafshëve të përkëdhelura,
2. kapja dhe largimi I kafshëve shtëpiake dhe kafshëve të përkëdhelura përveç se nga ana e ndërmarrjes së autorizuar,
3. ushqimi I qenve me mbeturina nga kafshët e therrura dhe pjesë të kafshëve të ngordhura,
4. futja e kafshëve shtëpiake në institucione publike, objekte fetare, kënde lojrash për fëmijë, tregje, përveç vendeve të bagëtive dhe vendeve tjera publike,
5. të futen kafshët e përkëdhelura në institucione publike, objekte fetare, kënde lojrash për fëmijë, tregje ose vende tjera publike,
6. nxjerrja dhe shëtitja e qenve në vende sportive, rekreative dhe vende tjera të tubimeve massive të qytetarëve, me përjashtim të sipërfaqeve të gjelbruara të cilat I cakton ndërmarrja kompetente publike,

7. larja e kafshëve shtëpiake dhe të përkëdhelura në pishina publike që gjinden në teritorin e komunës Preshevë dhe në çesme publike,
8. të lihen kufomat dhe pjesët e kafshëve të ngordhura në sipërfaqet publike,
9. varrosja e kafshëve të ngordhura dhe pjesëve të tyre jashtë vendit të caktuar për atë qëllim,
10. qethja dhe krehja e kafshëve dhe kafshët e përkëdhelura në parqe dhe në sipërfaqet tjera publike,
11. dhënja e ujit kafshëve dhe kafshëve shtëpiake në çesmet publike të dedikuara për furnizim me ujë të qytetarëve,
12. kujdesi dhe ushqimi në mënyrë të pavarur I qenve dhe macave endacak në sipërfaqet publike, në sipërfaqe të përbashkëta dhe oborret e ndërtesave banesore dhe shtëpive familjare, si dhe në oborre të shkollave, rrethet e fabrikave, kazermave, në parcelat e tregtive të mëdha ose në parcelat e personave tjerë juridik.

VI. MBIKQYRJA

Neni 32.

Punët e mbikqyrjes së inspekcionit ndaj zbatimit të dispozitave të këtij vendimi I kryen Adminsitrata komunale- Drejtoriati për punët e inspekcionit.

Punët e inspekcionit komunal në mirëmbajtjen e rendit komunal të rregulluar me këtë Vendim dhe kontrollit të zbatimit të vendimit në pajtim me Ligjin mbi policinë komunale dhe dispozitat tjera, i kryen inspekcioni komunal.

Pronari I kafshëve është I obliguar që inspektorit komunal ti mundëson kryerjen e papengueshme të punëve, mundëson hyrjen në objekte dhe kafshën, vendos në dukje të gjitha dokumentet e nevojshme dhe në afatin e caktuar dërgon të dhënat e duhura dhe vepron sipas urdhërit.

Neni 33.

Inspektori komunal është I autorizuar që në kryerjen e mbikqyrjes së inspekcionit:

- urdhëron kryerjen e obligimeve të përcaktuara dhe ndërmarrjen e masave për mënjanimin e mangësive,
- urdhëron mënjanimin, gjegjësisht zhvendosjen e kafshëve ose objekteve për vendosje kur ato mbahen në kundërshtim me Vendimin (e nuk ekziston mundësia që mbajtja e tyre të harmonizohet me

vendim) ose mbajtësi nuk i hjek me aktvendimin e inspektorit mangësit e përcaktuara.

- të ndërmerr masa tjera në pajtim me Ligjin dhe dispozitat e qytetit (shqipton dhe paguan ndëshkimin në shumën fikse në pajtim me dispozitat e ligjit dhe këtij vendimi, paraqet kërkesë për inicimin e procedurës së kundërvajtjes etj.

Neni 34.

Inspektori komunal është I autorizuar që në kryerjen e punëve të inspekcionit, me prezencën në vend të ngjarjes:

- pengon prishjen e rendit të paraparë me këtë vendim;
- kontrollon ekzekutimin e obligimeve të parapara me këtë vendim në vështirësi të vendit të hapsirës ku mbahen kafshët, kontrollon përmbytjen e obligimeve të parapara të mbajtësve të kafshëve dhe macave me rastin e nxjerrjes së tyre në sipërfaqe publike,
- vendos rendin e prishur me zbatimin e autorizimeve të veta të përcaktuara me Ligj.

Kur inspektori komunal vëren shkeljen e dispozitave të këtij vendimi, pranë autorizimit që janë përcaktuar me ligj, është I autorizuar që të:

- shqipton dhe paguan ndëshkimin e shumës fikse në pajtim me ligjin dhe dispozitat e këtij vendimi;

- paraqet kërkesë për inicimin e procedurës kundërvajtëse për kundërvajtje të paracaktuara me këtë vendim;

- paraqet deklaratë organit kompetent për veprën e kryer penale dhe

- njohton organet tjera kompetente të nërmarrin masa nga kompetencat e tyre,

V. DISPOZITAT NDËSHKUESE

Neni 35.

Me dënim në të holla në shumë prej 5.000 deri 75.000 dinarë, ndëshkohet për kundërvajtje personi fizik nëse:

1. nuk vepron me kafshët në pajtim me nenin 5 këtij vendimi,
2. mbanë kafshët shtëpiake në kundërshtim me nenet 8 dhe 9 këtij vendimi,
3. mbanë kafshët shtëpiake në kundërshtim me dispozitat e nenit 10 dhe 11 këtij vendimi,
4. mbanë njëthundrak dhe thundrak në kundërshtim me nenin 12. këtij vendimi,
5. mbanë lepuj në kundërshtim me dispozitat e nenit 13. këtij vendimi,

6. mbanë shpezët me pendë në kundërshtim me dispozitat e nenit 14. këtij vendimi,
7. mbanë pëllumba në kundërshtim me dispozitat e nenit 15. dhe 16. këtij vendimi,
8. mbanë qenë dhe maca në kundërshtim me dispozitat e nenit 17. dhe 18. këtij vendimi,
9. nuk e vendos tabelën në pajtim me nenin 19. këtij vendimi,
10. mbanë qenë në kundërshtim me dispozitat e nenit 21. këtij vendimi,
11. vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 24. Paragr. 1. dhe 2, 26. paragr. 1. dhe 3. këtij vendimi.

Neni 36.

Me dënim në të holla në shumë prej 50.000 deri 100.000 dinarë, ndëshkohet për kundërvajtje personi juridik

Nëse:

1. nuk vepron me kafshët në pajtim me nenin 5 këtij vendimi,
2. mbanë kafshët shtëpiake në kundërshtim me nenet 8 dhe 9 këtij vendimi,
3. mbanë kafshët shtëpiake në kundërshtim me dispozitat e nenit 10 dhe 11 këtij vendimi,
4. mbanë njëthundrak dhe thundrak në kundërshtim me nenin 12. këtij vendimi,

5. mbanë lepuj në kundërshtim me dispozitat e nenit 13. këtij vendimi,
6. mbanë shpezët me pendë në kundërshtim me dispozitat e nenit 14. këtij vendimi,
7. mbanë pëllumba në kundërshtim me dispozitat e nenit 15. dhe 16. këtij vendimi,
8. mbanë qenë dhe maca në kundërshtim me dispozitat e nenit 17. dhe 18. këtij vendimi,
9. nuk e vendos tabelën në pajtim me nenin 19. këtij vendimi,
10. mbanë qenë dhe maca në numër më të madh nga numri I qenve dhe macave të parapara me nenin 20. këtij vendimi,
11. mbanë qenë në kundërshtim me dispozitat e nenit 21 këtij vendimi.
12. vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 24. Paragr. 1. dhe 2, 25. paragr. 2. dhe 3, 26 paragr.1 dhe 3 këtij vendimi.

Për kundërvajtje nga paragr.1 këtij neni do të ndëshkohet personi përgjegjës në personin juridik me ndëshkim në të holla prej 5.000 deri 75.000 dinarë.

Për kundërvajtje nga paragr.1 këtij neni do të ndëshkohet ndërmarrësi me ndëshkim në të holla në shumë prej 10.000 deri 250.000 dinarë.

Neni 37.

Me ndëshkim në të holla në shumë fikse prej 5.000 dinarë do të ndëshkohet personi fizik nëse:

1. mbanë qenë dhe maca në numrin më të madh të qenve dhe macave të parapara me nenin 20. këtij vendimi,
2. nxjerr qenin jashtë pa zinxhirë dhe pa shportë mbrojtëse në gojë dhe nuk ka me vete vërtetimin për shënimin e bërë të qenit dhe vaksinimi.,
3. lëshon qenin në lëvizje të lirë në kundërshtim me dispozitën e nenit 27. Paragr. 1. këtij vendimi,
4. abuzon, torturon dhe braktis kafshët shtëpiake dhe kafshët e përkëdhelura,
5. fut kafshët shtëpiake dhe kafshët e përkëdhelura në hapsira zyrtare, sheshe dhe kande të lojrave të fëmijëve ose në vende tjera publike,
6. nxjerr dhe shëtit qentë në vende sportive, rekreative dhe vende tjera të grumbullimit masiv të qytetarëve, përveç në sipërfaqet e gjelbruara publike të cilat I cakton ndërmarrja kompetente publike.

VI. DISPOZITAT KALUESE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 38.

Pronarët gjegjësisht kujdestarët e kafshëve shtëpiake dhe personat juridik ose fizik që kanë lëndën e afarizmit ruajtjen dhe rritjen e kafshëve janë të obliguar që kushtet dhe mënyrën e mbajtjes dhe mbrojtjes së kafshëve shtëpiake ti harmonizojnë me dispozitat e këtij vendimi në afat prej 12 muaj nga dita e hyrjes së këtij Vendimi në fuqi.

Pronarët gjegjësisht kujdestarët e të përkëdhelësve shtëpiake në mbështetje të dispozitave të këtij Vendimi janë të obliguar që kushtet dhe mënyrën e mbajtjes dhe mbrojtjes së të njejtave ti harmonizojnë me dispozitat e këtij Vendimi në afat prej tre muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi.

Neni 39.

Me aktin e veçantë të Kuvendit të qytetit rregullohet procedura dhe mënyra e zgjidhjes së kërkesave të

qytetarëve për kompenzimin e dëmeve të shkaktuara gjatë kafshimit të qenit endacak.

Neni 40.

Veprimet që nuk janë përfunduara deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, do të përfundohen sipas dispozitave të vendimit që ka vlejte në momentin e procedurës së inicuar, nëse nuk janë në kundërshtim me Ligjin dhe dispozitat e këtij Vendimi.

Neni 41.

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në "Gazetën zyrtare të komunës Preshevë".

KËSHILLI KOMUNAL I KOMUNËS PRESHEVË

III:nr.32-1

Në Preshevë më 30.05.2025

K r y e t a r j a
Ardita Sinani d.v